

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë
Tel/Faks +355 4 2234487
E-mail info@arrsh.gov.al
Ueb-faqe www.arrsh.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Brunild Daci
E-mail brunild.daci@arrsh.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur - Punë publike - prokurim me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës / Marrëveshjes kuadër: Realizimi i punimeve

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-89963-03-12-2021

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakës”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): - Punime ndërtimi për autostrada, rrugë_45233100-0

8. Fondi limit: 124.503.327,1 (njëqind e njëzet e katër milion e pesëqind e tre mijë e treqind e njëzet e shtatë presje një) Lekë, pa përfshirë vlerën TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të Nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka në zbatim kontratën nr. 2623/6 prot, datë 26.05.2021 me objekt: “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakës”, me REF-89963-03-12-2021

- Vlera e kontratës është 121.508.153 Lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së)
- Afati i kësaj kontrate është 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Më datë 10.06.2022 për këtë kontratë është bërë amendim i saj, në të cilën është zgatur afati i përfundimit të kësaj kontrate, duke përcaktuar si afat të përfundimit datën 30.11.2023.

*Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe e Operacioneve me shkresën nr. 7943 prot, datë 10.10.2023, ka paraqitur relacionin teknik, në të cilin janë paraqitur dhe prezantuar të gjitha shkaqet që kanë çuar në nevojën për këtë modifikim kontrate.

- ❖ Për këtë modifikim janë plotësuar njëkohësisht të dyja nënpikat i) dhe ii) të parashikuara në paragrafin b) të pikës 1 të Nenit 127 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Konkretisht, nënpika i) plotësohet, pasi këto punime jashtë kontrate janë të lidhura ngushtë dhe ndërveprojnë me punimet e kontratës bazë (realizimi i punimeve të tombinos box i parashikuar te shtesa e punimeve duhet realizuar më parë se shtresat asfaltike mbi tombino të parashikuara në kontratën bazë).

Pra, punimet jashtë kontrate janë bashkëplotësuese me punimet e kontratës bazë.

Ndërsa nënpika ii) plotësohet, pasi nuk mundet kurrësesi që një operator të ofertoje me lire se ai aktual, duke pasur parasysh që:

- Rritja e çmimeve të ndodhura krahasuar nga periudha e nënshkrimit të kontratës fillestare (Maj 2021) me periudhën aktuale.
- Vazhdimësia e kontratave të furnizimit që ka aktualisht kontraktori.
- Kosto shtesë që vijnë nga përsëritja e shpenzimeve për ngritjen e kantierit nga kontraktori “i ri”.
- Kostot shtesë për mobilizimin e stafit teknik drejtues të punimeve.

- ❖ Gjatë realizimit të punimeve, Kontraktori është ndeshur me kushte që kanë penguar zbatimin në kohë të kësaj kontrate. Konkretisht, vonesa në kryerjen e shpronësimeve.

Kjo problematikë është raportuar periodikisht nga Mbikëqyrësi i punimeve, kjo gjë ka sjellë si pasojë pezullimin e punimeve më datë 04.02.2022. Nga data 04.02.2022-06.06.2022 punimet kanë qënë të pezulluara dhe për arsyet e lartë përmendura më datë 10.06.2022 është bërë amendimi për zgjatjen e afatit të punimeve, me 16 muaj total.

Sqarojmë se këto punime shtesë nuk mund të parashikoheshin që në projektim, për arsyet e mëposhtme:

- a. Drejtimi i rampes dalese te ures ekzistuese ne drejtim te fllakes erdhi si nevojë e parametrave të sigurisë rrugore;
- b. Zgjatja e tombinos tip BOX 4.1x1.75 erdhi si nevojë për zgjidhjen e problematikave të përmbytjeve në objekt.
- c. Aksesit i bizneseve/pronave ne drejtim Dures-Maliq Muco, erdhi si nevojë e zgjidhjes së hyrje-daljeve të bizneseve në pronën e tyre, duke ruajtur parametrat e sigurisë;
- d. Aksesit i bizneseve/pronave ne drejtim Maliq Muco – Tirane, erdhi si nevojë e zgjidhjes së hyrje-daljeve të bizneseve në pronën e tyre, duke ruajtur parametrat e sigurisë;
- e. Asfaltimi i segmenteve te demtuara. Kohëzgjatja nga projektimi në zbatim solli degradimin e segmenteve ekzistuese;
- f. Rishikim i projekt - preventivit, si pasoje e rakordimit te volumeve.

Nga sa më sipër, ishte e pamundur parashikimi i këtyre punimeve jashtë kontrate që në fazën e projektimit.

Vlera e punimeve jashtë kontrate e tejkalon disa herë vlerën e fondit rezervë, fond, i cili është ezauruar për pjesën e punimeve, të cilat janë realizuar në radhë teknologjike më përpara se të lindte nevoja për punimet jashtë kontrate.

Propozimet për këto punime shtesë nuk kanë ardhur 1.5 vite pas nënshkrimit të kontratës, por menjëherë pas fillimit të punimeve.

Konkretisht, shkresa nga Kontraktori më datë 26.05.2021 (pra, brenda afatit të kontratës bazë), në të cilën parashtrohen disa problematika të përmendura më sipër.

Nga data 23.08.2022-19.12.2022 nëpërmjet korrespondencës shkresore midis Mbikëqyrësit të Punimeve në bashkëpunim me Kontraktorin pranë AK është dorëzuar materiali për ndryshime në projekt, ku janë pasqyruar qarte të gjitha punimet, si dhe vlera ekonomike e tyre, të cilat janë shumë të rëndësishme për përfundimin dhe plotësimin e objektit.

Me datë 19.12.2022 është marrë vendimi nga Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar për miratimin e propozimeve të paraqitura nga Mbikëqyresin dhe Sipermarresi i Punimeve, për përmirësimin, plotësimin dhe modifikimin e projektit preventiv për objektin: “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakes”. Në mënyrë të përbledhur vendimi konsiston:

- a) Te miratoje përdorimin e fondit rezerve të paraqitur.
- b) Autorizoi Mbikëqyresin e punimeve të dorëzojë preventivin e punimeve që ngelen jashtë vlerës së kontratës (preventivin e punimeve shtesë) me vlerë 24.301.631 leke pa tvsh.

Pra, siç është përcaktuar dhe nga Vendimi i Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar, pas ezaurimit të Fondit Rezerve me vlerë 5.786.102 leke, mbeten jashtë kontratës punimet me vlerë 24.301.631 leke pa tvsh.

Pra, VKT për ndryshimet, përmirësimet, plotësimet dhe modifikimet për këtë objekt është marrë 1.5 vite nga data e nënshkrimit të kontratës, por propozimet për këto ndryshime janë paraqitur gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve të kontratës bazë.

Argumentojmë se ndodhemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas parashikimit ligjor të sipërcituar.

Bazuar në pikën 6 të Nenit 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor”; dhe

në pikën 7 të këtij neni “Në rastet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të nevojshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.

si dhe Nenit 36 “Ndryshim i Porosisë”, të kontratës bazë, pikat

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

36.2 Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë Kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrëveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.

Propozimet e Mbikëqyrësit, të cilat konsistojnë në përmirësimin e projektit pas shqyrtimit në Këshillin Teknik të ARRSH-së janë miratuar në parim me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 42, datë 19.12.2022. Referuar modifikimit të kësaj kontrate, rishikimi i projektit lind si nevojë gjatë zbatimit të projektit, në të cilat një nga detyrat e Mbikëqyrësit e mirëpërcaktuar në Termat e Referencës është, si më poshtë:

“Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë ARRSH-së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse), ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARRSH-ja”.

si dhe referuar Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, Kreu I, pika 7.2 në të cilin citohet:

“Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës”.

Më pas, miratimi nga ARRSH kryhet në parim nga Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i mbledhur nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së (Kryetar); drejtorë të drejtorive të ARRSH-së; dhe specialistë të fushës. Pas miratimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së, Mbikëqyrësi i punimeve dorëzon materialin e nënshkruar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Në total:

Për realizimin e punimeve për përfundimin e punimeve të këtij objekti me ndryshimet e bëra vlera e këtij objekti është: 145,809,783 Lekë pa TVSH

Vlera e punimeve sipas projektit të tenderuar: 121,508,152 Lekë pa TVSH

Me Vendimin e Këshillit Teknik është vendosur:

Vlera e punimeve që mbeten jashtë vlerës së preventivit të kontratës së tenderuar prej: 24,301,631 Lekë pa TVSH të merren në preventivin me objekt: “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakës”, (Modifikim projekti).

Punimet e përfshira në preventivin “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakës” (Modifikim projekti) janë domosdoshmëri të kryhen nga Kontraktori, aktualisht, për shkak të arsyeve të mëposhtme:

1. Ndërthurjes me punimet e kontratës bazë.

Punime jashte kontrates, nga natyra dhe funksioni i tyre duhen cilesuar patjeter si pjese perberese e kontrates, pasi pa realizuar keto punime objekti nuk eshte funksional dhe i plote, dhe me shume mangesi per elementet e sigurise rrugore. Zgjatimi i Tombinos box eshte i domosdoshem, pa kete zgjatim rampa nga Fllaka ne drejtim te Durrësit mbetet e nderprere dhe jo funksionale. Drejtimi i ures ekzistuese i domosdoshem per rritjen e parametrave te sigurise, prej vitesh nje vater e zeze aksidentesh. Zgjerimi i korsise dalese nga Xhafzotaj-Tirane i domosdoshem per rritjen e parametrave te sigurise. Gjithashtu dhe riparimi i shtresave ekzistuese te asfaltit eshte i domosdoshem per plotesimin e objektit.

2. Kostoja e ndërtimit

Nuk mundet kuresesi qe nje operator te ofertoje me lire se ai aktual, duke pasur parasysh qe:

- Rritja e çmimeve të ndodhura krahasuar nga periudha e nënshkrimit të kontratës fillestare (Maj 2021) me periudhën aktuale.
- Vazhdimësia e kontratave të furnizimit që ka aktualisht kontraktori.
- Kosto shtesë që vijnë nga përsëritja e shpenzimeve për ngritjen e kantierit nga kontraktori “i ri”.
- Kostot shtesë për mobilizimin e stafit teknik drejtues të punimeve.

3. Menaxhimi i trafikut

Angazhimi i një operatori tjetër ekonomik do të shkaktojë probleme në menaxhimin e trafikut dhe askush nuk do të mbajë përgjegjësi për sigurinë rrugore.

Nga sa më sipër, bazuar në Nenin 127 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

a) Autoriteti Kontraktor nuk mund të parashikonte mospërputhjet midis projektit-faktit, si dhe nevojave dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve në funksion të komunitetit dhe përdoruesve të rrugës.

b) Këto modifikime nuk ndryshojnë natyrën e kontratës, pasi të gjithë zërat e ndryshuar janë pjesë e preventivit dhe kontratës bazë, si dhe janë në vazhdimësi të objektit të kësaj kontrate për të cilën kërkohet miratimi i modifikimit.

c) Kontrata shtesë nuk kalon 20% të vlerës së kontratës bazë. Autoriteti Kontraktor vlerëson se kostoja e përgjithshme e këtyre punimeve është më e vogël, pasi çmimet e preventivit të këtyre punimeve shtesë mbeten ato të tenderuara në kontratën bazë dhe të negociuara.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës / Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

- Drejtimi i rampes dalese te ures ekzistuese ne drejtim te Fllakes
- Zgjatja e tombinos tip BOX 4.1x1.75
- Asfaltimi i segmenteve te demtuara.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 24,301,631 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 145.809.783 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj
Dhe afati i ri (nëse është rasti): 15 muaj

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve ekonomik/ë:

Emri: “A.L-ASFALT” SHPK

NIPT: K81511508A

Adresa: Durres Xhafzotaj Sallmone Rruga Hoxheve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36

Kontaktet: 0682080609 0684018777

e-mail: alASFALT.financa@yahoo.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 23/11/2023

16. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____